



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 226

Datë: 18/2/2022

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 22, paragrafit 1.5 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në zbatim të nenit 170 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me datë 10.02.2022 nxjerrë këtë:

V E N D I M

Për përcaktimin e ngarkesës në punë dhe angazhimet në institucionë/ndërmarrje publike apo private, vendore apo ndërkombëtare, brenda apo jashtë vendit të personelit akademik të Universitetit të Prishtinës

1. Personeli akademik i Universitetit të Prishtinës në marrëdhënie të rregullt të punës është i obliguar të përbush detyrimet e tij/saj, të përcaktuara me Ligjin për Arsimin e Lartë, Ligjin e Punës, Statutin e UP-së dhe kontratën e punës, sipas mënyrës së përcaktuar nga njësia akademike përkatëse. Detyrimet kontraktuese të personelit akademik, në kuptim të kësaj pike përfshijnë:
 - 1.1. mësimdhënien sipas koeficientit të përcaktuar me rregullat në fuqi të UP-së;
 - 1.2. kërkimet shkencore dhe krijmtarinë artistike;
 - 1.3. organizimin dhe mbajtjen e provimeve;
 - 1.4. pjesëmarrjen në komisionet për vlerësime të studimeve dhe gradave akademike si dhe komisionet e tjera brenda njësisë akademike dhe Universitetit;
 - 1.5. pjesëmarrjen dhe kontributin në forumet vendimmarrëse të njësisë akademike (Katedër, Departament, Këshill, etj.);
 - 1.6. kryerjen e detyrave në kuadër të komisioneve, projekteve dhe detyrave të tjera të përcaktuara nga dekani i njësisë akademike ose Rektori;
 - 1.7. mbikëqyrjen dhe vlerësimin e punimeve seminarike;
 - 1.8. mentorimin e studentëve të studimeve post-diplomike dhe çdo detyrë tjeter që hyn në fushëveprimin e natyrshëm të funksionit mësimdhënës;
 - 1.9. detyra të tjera zyrtare të caktuara nga njësia akademike, të ndërlidhura me natyrën e angazhimit të personelit akademik, sipas Statutit të UP-së, veçanërisht neneve 171 dhe 186, si dhe akteve tjera juridike relevante në fuqi.
2. Njësitë akademike, varësisht nga specifikat, mund të vendosin rregulla të veçanta, përkitazi me përbushjen e detyrave të personelit akademik, të përcaktuara me Statut dhe me këtë vendim.
3. Personeli akademik është i detyruar që së paku dy herë në javë të ketë qëndrim në zyrë ose në salla, sipas një orari të përcaktuar, me qëllim të zhvillimit të konsultimeve për studentë, në lidhje me realizimin e detyrave të punës.

4. Përjashtim nga pika 3 e këtij vendimi bëhet vetëm në rastet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, veçanërisht në situata të pandemisë dhe raste të ngjashme që shkaktohen si rezultat i fuqisë madhore, apo kur me vendim të veçantë, për shkak të natyrës së mësimit dhe detyrave të tjera të personelit akademik caktohet ndryshe.
5. Organizimi i punës për personelin akademik në studimet themelore, master dhe të doktoratës në njësitë akademike do të bëhet nga menaxhmenti i njësisë përkatëse, duke pasur parasysh detyrat e personelit akademik, sipas këtij vendimi dhe Statutit të UP-së, si dhe aktet tjera juridike relevante në fuqi. Në organizimin e punës për personelin akademik, menaxhmenti i njësisë akademike do të veproj në pajtim të plotë me nenet përkatëse të Ligjit të Punës në fuqi në Republikën e Kosovës.
6. Personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UP, i ndalohet të themeloj marrëdhënie tjetër të rregullt pune në një institucion publik ose privat, vendor apo ndërkombëtar, brenda apo jashtë vendit. Gjithashtu, personeli akademik nuk mund të ketë marrëdhënie të rregullt pune me UP-në dhe të jetë i emëruar në një institucion publik ku natyra e emërimit të tij dhe ngarkueshmëria në kuptim të angazhimit do të përputhej me specifikat e marrëdhënieve së rregullt të punës, pra qëndrim në zyrë brenda një orari të rregullt të punës i cili përputhet me orarin e rregullt të punës në UP (gjyqëtar, prokuror, ministër, këshilltar politik, shef ekzekutiv, e të ngjashme, si dhe angazhime të tjera që ndikojnë në mos përbushje të detyrave në UP). Nuk përjashtohen mundësitë e angazhimit që i njeh Ligji i Punës në Kosovë dhe angazhimet apo emërimet specifike në trupa/organe kolegjiale me funksion mbikëqyrës në institucionet dhe agjenci publike të pavarura, me ngarkueshmëri siç përcaktohet me dispozitat e këtij vendimi, e që nuk cilësohet marrëdhënie e rregullt pune, ose përjashtohen nga marrëdhënia e rregullt e punës e njohur sipas ligjeve në vend dhe që në asnjë rrethanë nuk ndikojnë në përbushjen e detyrave të punës në UP.
7. Personeli në marrëdhënie të rregullt pune në UP, kanë të drejtë të angazhohen në cilësi të ekspertit profesional për nevoja të ekspertizave, konsulencave apo pjesëmarrjes në komisione ose grupe punuese në institucionet publike apo private, vendore ose ndërkombëtare, me kusht që këto angazhime të mos ndikojnë në përbushjen e detyrave të përcaktuara me kontratën e punës, Statutin e UP-së dhe këtë vendim. Monitorimin e kryerjes së detyrave të punës në UP ka për obligim t'a përcjell dhe raportoj dekani i njësisë akademike.
8. Angazhimi në marrëdhënie pune të kufizuar në pajtim me nenin 170 të Statutit dhe këtë vendim, në një institucion të arsimt të lartë jashtë Universitetit të Prishtinës mund të bëhet pas njoftimit të dekanit të njësisë akademike dhe Rektorit të Universitetit, nëse punëdhënësi i tillë ushtron veprimtari konkurruese me Universitetin e Prishtinës, si: universitet tjetër publik ose privat, apo institut kërkimor.
9. Marrëdhënia e jashtme e punës në një universitet publik apo privat apo institut shkencor ose institucionet të ngjashme, në kuptim të pikës 8 të këtij vendimi, nuk mund të kaloj më shumë se katër (4) orë angazhim në javë.

10. Njostimi për realizimin e angazhimit të personelit akademik, sipas pikës 8 dhe 9 të këtij vendimi duhet të përcaktoj ngarkesën e ligjërimit për orë për javë, dhe periudhën kohore (ditën dhe orën) kur do të realizohen orët e tilla dhe nuk duhet të kaloj orët e përcaktuara me pikën 9 të këtij vendimi.
11. Aktiviteti i jashtëm mësimor/arsimor i personelit akademik të Universitetit, në marrëdhënie të rregullt pune që realizohet sipas një marrëveshje ndërmjet Universitetit të Prishtinës dhe një institucionit tjetër të arsimit të lartë brenda apo jashtë vendit, nuk mund të kaloj normën prej gjashtë (6) orë në javë me përashtim kur një gjë e tillë specifikohet ekskluzivisht me marrëveshjet e tilla dhe ka të bëjë me ndonjë lëmi specifike që mund të shoqërohen edhe me mungesë të kuadrove.
12. Nëse personeli akademik i Universitetit dëshirojnë të zhvillojnë më shumë se 30% të programit studimor në institucionin tjetër të arsimit të lartë, Senati mund të jap pëlqimin për aktivitetin e tillë vetëm nëse bëhet fjalë për programin e përbashkët të Universitetit dhe të institucionit tjetër të arsimit të lartë.
13. Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UP është i detyruar të respektoj marrëdhënen e tij/saj të punës me UP-në, në të gjitha rastet ku ai/ajo ushtron punësim apo angazhim tjetër të përkufizuar sipas këtij vendimi, duke e paraqitur në mënyrë transparente titullin e tij/saj akademik dhe Universitetin e Prishtinës si punëdhënës primar.
14. Personelit akademik të Universitetit të Prishtinës, i ndalohet të marr pjesë në aktivitete promocionale dhe/apo akademike në favor të një institacioni tjetër arsimor/kërkimor, në mënyrë të tillë që të dërmtoj karakterin konkurrues të UP-së në tregun e arsimit të lartë dhe hulumtimit shkencor.
15. Ndërlidhur me pikën 14 si dhe pikat e tjera të këtij vendimi, Rektori, bazuar në propozimin e dekanit të njësisë akademike, mund t'i ndaloj dhe kufizoj kontraktimin e punës jashtë Universitetit të të punësuarit si personel akademik, nëse një gjë e tillë ndikon negativisht në reputacionin dhc/apo karakterin konkurrues të UP-së në tregun vendor dhe ndërkombëtar.
16. Rektori, në bashkëveprim me dekanët e njësive akademike, mund të inicioj procedura përkatëse ndaj personelit akademik që bëjnë shkelje të dispozitave të këtij vendimi, veçanërisht për dështimin në përmbytjen e detyrave të punës së rregullt në UP. Në një rast të tillë Rektori duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e parapara me legjislacionin në fuqi fillimisht për rivendosjen e pajtueshmërisë me këtë vendim në rastet e shkeljeve (fillimisht njoftimi i personelit përkatës mbi shkeljen me qëllim të shmangies apo eliminimit të saj) dhe pastaj zbatimi i procedurave dhe masave përkatëse të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

17. Personeli akademik që përveç Universitetit të Prishtinës ka edhe ndonjë marrëdhënie/kontratë tjeter të rregullt pune në ndonjë institucion publik apo privat, ndërmarrje publike apo private brenda apo jashtë vendit dhe/apo persona juridik të cilësdo fushëveprimtari apo status ligjor, obligohet që deri më 20 shtator të secilit vit kalendarik, të përcaktohet nëse do të ketë marrëdhënie të rregullt pune me Universitetin e Prishtinës apo jashtë Universitetit të Prishtinës.
18. Personeli akademik i cili përcaktohet për marrëdhënie të rregullt punc me pagë primare në një institucion tjeter jashtë UP-së, në Universitetin e Prishtinës do t'i pushojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet sipasi Ligjit të Punës për sa kohë është në pozitën apo funksionin përkatës. Në rast se i njëjti/ta, angazhohet në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm, kompensimi bëhet vetëm për orët e mbajtura gjatë periudhës semestrale, por jo më shumë se fondi i orëve të honorarit të përcaktuar sipas Rregullores në fuqi, për të ardhurat personale të personelit akademik të UP-së.
19. Personeli me thirrje akademike: Profesor asistent, Profesor i asocuar dhe Profesor i rregullt që mban postin e Rektorit në njërin prej universiteteve publike brenda Republikës së Kosovës, do të trajtohet sipas pikës 17 të këtij vendimi.
20. Personeli i zgjedhur apo i emëruar në institucione publike sipas këtij vendimi rregullohet si vijon: Personeli akademik i zgjedhur në institucione publike, (sipas Kushtetutës, Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale) apo i emëruar në poste publike jashtë Universitetit të Prishtinës, duke përfshirë edhe këshilltarët politik, duke përashtuar këshilltarët e jashtëm, gjatë periudhës së ushtrimit të postit publik do të kompensohen vetëm për orët e mbajtura gjatë periudhës semestrale, në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm, por jo më shumë se fondi i orëve të honorarit të përcaktuar sipas Rregullores në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik të UP-së. Duke ndjekur qëllimin dhe frymën e këtij vendimi si dhe në funksion të zbatimit edhe të ligjeve që indirekt krijojnë të drejta/mundësi ligjore për personelin akademik dhe detyrime për UP-në në mbështetje të institucioneve dhe agjencive të pavarura të Republikës së Kosovës me ekspertizë akademike, e për të cilët kriter formal esencial është të qenurit pjesë e Universitetit (Këshilli i Shtetëror i Cilësisë, Këshilli Drejtues i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës e të ngjashme), apo kriter formal esencial është përvoja akademike dhe se ngarkueshmëria e tyre përpunhet me definimin e përcaktuar në këtë vendim (emërimi në Bordin e RTK-së, Bordin e BQK-së, Bordin e Fondit të kursimeve pensionale të Kosovës, Bordet e institucioneve tjera të ngjashme publike dhe private), konsiderohet si mundësi për mbështetjen e institucioneve shtetërore, ngjashëm me Universitetet tjera gjithandjej nëpër vendet e përparuara, ku bota akademike është e përfshirë në të gjitha projektet zhvillimore të shtetit, duke bartur ekspertizën dhe përvojën e tyre shkencore dhe profesionale në funksion dhe për interes publik.
21. Personeli akademik në Fakultetin e Mjekësisë të UP-së, që mbajnë pozita të drejtoreve të klinikave në kuadër të ShSKUK/QKUK-së, pagë primare do të kenë pagën në ShSKUK/QKUK.
22. Personeli akademik, në kuptim të pikës 18, 19 dhe 20 të këtij vendimi, në rast të pezullimit të të drejtave dhe detyrave nga marrëdhënia e punës kur zgjedhet apo emërohet në funksione publike, pas përfundimit të mandatit, ka të drejtë të kthehet te punëdhënësi brenda afatit prej pesë (5) ditësh, pa pasur nevojë që t'i shpallet konkurs publik, në përpunhje me Ligjin e Punës në fuqi.

23. Dekanët e njësive akademike janë përgjegjës për përcjelljen dhe mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së procesit mësimor (përfshirë: ardhje-vajtjen në punë, mbajtjen e mësimit, pjesëmarrjen në mbledhje të këshillit të fakultetit apo komisioneve tjera profesionale, kryerjen e detyrave që përcaktohen në kuadër të komisioneve dhe projekteve ku caktohen, sjelljen me studentë dhe personel tjetër, etj.) si dhe përmbushjen e detyrimeve tjera të personelit akademik sipas këtij vendimi dhe raportimin me kohë të të gjitha rasteve që nuk veprojnë në pajtim me këtë vendim, si dhe marrjen e masave konkrete, bazuar në Statut dhe rregulloret në fuqi të Universitetit të Prishtinës.
24. Rektori, prorektorët, dekanët, prodekanët, shefat e qendrave dhe koordinatorët e zyrave në parim nuk mund të kenë angazhim tjetër shtesë jashtë UP-së për mësimdhënien me kontratë sekondare të punës në Universitetet tjera brenda apo jashtë vendit, brenda orarit ditor të punës, për shkak të përgjegjësive menaxheriale që kanë.
25. Rektori, prorektorët, dekanët, prodekanët, shefat e qendrave dhe koordinatorët kanë të drejtë që të kërkojnë leje dhe të angazhohen në mësimdhënien jashtë UP-së jashtë orarit ditor të punës. Për prodekanët, shefat e qendrave dhe koordinatorët e zyrave, kërkesa miratohet ose jo nga dekani i njësisë akademike. Për prorektorin dhe dekanin e njësisë akademike kërkesa miratohet ose jo nga Rektori, ndërsa në rastin e angazhimit të Rektorit, kërkesa miratohet ose jo nga Këshilli Drejtues i Universitetit, dhe për këtë njoftohet edhe Senati.
26. Në çdo rast, kërkesa e parashtruar sipas pikës 24, nga Rektori, prorektorët, dekanët, prodekanët, shefat e qendrave dhe koordinatorët, duhet t'i përbahet dispozitave të këtij vendimi, si dhe e njëjta nuk mund të realizohet brenda orarit ditor të punës, sipas pikës 23 të këtij vendimi.
27. Dekani është i obliguar që të njoftoj Rektorin përmes një raporti përbledhës për angazhimet e personelit akademik të njësisë akademike që ai/ajo e udhëheq, në institucionet e arsimit të lartë si dhe angazhimet e tjera të parapara në pikën 19, sipas dispozitave të këtij vendimi. Raporti dërgohet të paktën një (1) herë brenda vitit akademik.
28. Personeli akademik i cili nuk e respekton afatin e përcaktuar në pikën 16 të këtij vendimi, do të njoftohet për **inicimin** e procedurës disciplinore dhe mundësinë e ndërpërjes së kontratës së punës. Në rast të veprimit në kundërshtim me këtë vendim, Universiteti i Prishtinës mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit nga radhët e personelit akademik sipas procedurave ligjore, me një periudhë paralajmërimi në këto intervale kohore të njoftimit:
- a. prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësimi, tridhjetë (30) ditë kalendarike;
 - b. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzet e pesë (45) ditë kalendarike;
 - c. mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.
29. Këshilli i Etikës është organi kompetent sipas Rregullores për procedurat disciplinore të UP-së, për të vendosur **mbi rastet e inicuara** për shkeljen e këtij vendimi, dhe/apo rregullativës në fuqi, në lidhje me çështjet që rregullohen me këtë vendim.

30. Këshilli Drejtues i UP-së mban të drejtën ekskluzive për përditësimin dhe interpretimin e këtij vendimi sa herë që e konsideron të nevojshme apo edhe sipas kërkesave ligjore. Ndërlidhur me këtë, Këshilli do të shqyrtoj kërkesat/ankesat eventuale mbi zbatimin jo efikas dhe jo të drejtë të këtij vendimi nga ana e subjekteve përgjegjëse për zbatimin e tij.
31. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Këshillit Drejtues të UP-së nr.3/881 i 11.12.2020
32. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Arsyetim

Mbështetur në rritjen e cilësisë dhe fuqizimit të kapaciteteve të UP-së, sidomos në rrethanat aktuale ku konkurrueshmëria në arsimin e lartë në vend është sfiduese, kërkohet që aktet si ky dhe të ngjashme të plotësohen që të kontribuojnë në një arsimim të lartë cilësor, konkurrent, me nxjerrjen e kuadrove të kërkuara nga tregu i punës si dhe në ngritjen e përgjithshme të performacës së punës së UP-së.

Në shërbim të kësaj, përditësimi i këtij vendimi pikërisht tanë ka qenë i nevojshëm pasi që edhe pas masave të ndërmarrja në zbatim të vendimit paraprak nr.3/881 i datës 11.12.2020, Këshilli Drejtues është përballur me reagime dhe ankesa nga personeli akademik për mos zbatim efikas, të drejtë, për zbatim të përgjithësuar dhe është parë nevoja e mbulimit të zbratzësive të krijuara në ofrimin e ekspertizës së stafit akademik në interes të shtetit, në të gjitha fushat. Këshilli Drejtues, pa paragjykuar rezultatin e këtyre ankesave, reagimeve dhe kërkesave, si dhe me qëllim të eliminimit të rrethanave që në të ardhmen mund ta vënë UP-në në risk të reputacionit legal apo edhe material, ka vendosur të rishikoj vendimin me nr. 3/881 të datës 10.11.2020.


Përveç këtyre rrethanave që u përmenden si më sipër, Këshilli Drejtues ka pasur në konsideratë që ende një numër i konsideruar i personelit akademik të UP-së, përveç marrëdhënies së rregullt të punës në UP, mbajnë edhe funksione publike apo angazhime të tjera në institucione vendore (me ngarkueshmëri që ngjan me marrëdhënie të rregullt të punës të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi), trajtimi i të cilave mund të ketë qenë i vështirësur nga përbajtja e vendimit paraprak, andaj bëri që përditësimi i tij të jetë i domosdoshëm.

Njëherësh duke u bazuar edhe në detyrime që mund të rrjedhin nga ligje që nuk i dedikohen drejtëpërdrejtë UP-së por indirekt mund të ndërlidhen me funksionin e tij, Këshilli Drejtues i UP-së me këtë përditësim të vendimit paraprak maksimizon pajtueshmërinë e tij me aktet përkatëse më të larta dhe nuk kufizon ekspertizën akademike për akterët e rëndësishëm të vendit dhe mbi të gjitha rrit cilësinë e punës dhe kontrollin efektiv të saj, siç e bëjnë të gjitha shtetet e zhvilluara duke shfrytëzuar dijen e personelit akademik universitar në secilin segment të zhvillimit të jetës dhe në interes të përgjithshëm të shtetit dhe shoqërisë, gjithmonë duke mos e cënuar funksionalitetin e UP-së dhe duke respektuar me përpikmëri kryerjen e të gjitha detyrimeve ndaj UP-së pa asnjë përjashtim.

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit, përgjegjësisë dhe vijueshmërisë në punë si dhe përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie, në kuadër të zbatimit të Ligjit të Punës, Statutit të UP-së dhe akteve tjera juridike përkatëse në fuqi, Këshilli Drejtues i UP-së lidhur me caktimin e parimeve të punësimit, të të drejtave, detyrimeve dhe kushteve tjera për personel, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Drejtues, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të këtij vendimi i kushtoi vëmendje të veçantë: parimit të lirisë së punës të elaboruar qartësisht nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. KO131/12, paragrafët 160 e tutje, praktikave më të mira në Universitetet simotra të vendeve të ndryshme me të cilat ka bashkëpunim UP-ja, si dhe analizës së rrëthanave aktuale që u thanë më sipër, gjë që rrjedhimisht ndikuan në nxjerrjen e këtij vendimi me përbajtjen e përcaktuar si në dispozitiv.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Rektorit të UP-së;
3. Dekanëve të njësive akademike;
4. Sekretarëve të njësive akademike;
5. Shërbimit të financave të UP-së, dhe
6. Administratorit të ueb-faqes së UP-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e publikimit të tij sipas procedurave statutare dhe ligjore.